

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për ta administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike me të dhënat sikur në vijim:

Titulli i pozitës: AUDITOR I BRENDSHËM I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Orët e punës: Jo më shumë se 120 ditë në vit

Numri i referencës: KON072024

Kohëzgjatja e emërimit: Kontratë për punë dhe detyra specifike

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- E vlerëson nëse veprimtaria e FKPK-së në fushën e TI-së zhvillohet në përputhje me politikat dhe procedurat e institucionit për sektorin e TI-së.
- E vlerëson nëse politikat dhe procedurat aktuale të TI-së në FKPK janë në përputhje me rregulloret përkatëse të Bankës Qendrore të Kosovës dhe të duhura për veprimtarinë e institucionit.
- I vlerëson rreziqet të cilave iu ekspozohen sistemet informative dhe shënimet e FKPK-së.
- E vlerëson vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e TI-së në rast të shpërthimeve/keqfunksionimeve infrastrukturore ose fatkeqësive madhore.
- E vlerëson ndarjen e përgjegjësisë, mjaftueshmërinë e personelit të TI-së, ekspertizën dhe nevojat për trajnime brenda sektorit të TI-së.
- I shqyrton të drejtat e shfrytëzuesve, si dhe kontrollet e brendshme ekzistuese, të ndërlidhura me veprimet e tyre në aplikacionet kryesore administrative të FKPK-së.
- E planifikon procesin e auditimit të TI-së, në bazë të risqeve të identifikuara dhe e dërgon planin përkatës (në gjuhën shqipe dhe angleze) për shqyrtim dhe miratim nga Bordi.
- E përgatit letrën e punës për dokumentimin e testimeve të bëra në lidhje me Auditimin e TI-së dhe të njëjtat i dërgon tek Njësia e Auditimit të Brendshëm.
- E përpilon raportin (në gjuhën shqipe dhe angleze) mbi të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit të TI-së, sipas standardeve dhe praktikave më të mira, dhe i raporton tek Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe tek Komisioni i Auditimit/Bordi.
- I kryen edhe detyrat e tjera që mund t'i caktohen nga Bordi Drejtues dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm për Auditimin e TI-së

Kriteret profesionale:

- Arsimimi dhe certifikimet:**
- Të jetë i/e diplomuar - të paktën në nivelin baçelor.
 - Të ketë certifikim CISA ose CRISC të lëshuara nga ISACA.
 - Të ketë njohuri të gjuhës angleze - në të shkruar dhe në të folur.

- Përvoja:**
- Të ketë së paku dy vjet përvojë profesionale në auditimin e TI-së.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur prej: **18 shtatorit e deri më 2 tetor 2024** në 23:59 (CET).
- Aplikimi vetëm përmes postës elektronike në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: "IT Audit 2024". Email-it duhet t'i bashkangjiten dokumentet në vijim: 1) Biografia (CV), 2) Letra motivuese, 3) Dëshmi që e mbulojnë kërkesën për përvojë së paku dy vjeçare në auditimin e TI-së, 4) Kopje të skanuar të diplomës së kualifikimit më të lartë arsimor dhe 5) Certifikatat përkatëse profesionale (p.sh. CISA).

Vëmendje:

- Kufizimi në pranimin e dokumenteve është 10 MB - në rast se është e domosdoshme atëherë dokumentet duhet të dërgohen përmes një linku të caktuar (por gjithnjë në formatin pdf).
- Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit do të kontaktohen.
- Të gjitha dokumentet mund të dërgohen në gjuhën shqipe ose angleze ose serbe.

FKPK-ja është punëdhënëse që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!